



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:246384

Datë: 10.01.2024

Numri i dokumentit: 05173212

AA.nr.1010/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit - propozuesit M... B..., nga fshati B..., komuna e Drenasit, kundër të paditurës/kundërpropozueses Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Komisioni për Siguri dhe Shëndet në Punë, me baza juridike anulim vendimi me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit - propozuesit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1972/2023, të datës 01.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit - propozuesit M... B..., nga fshati B..., komuna e Drenasit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1972/2023, i datës 01.12.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1972/2023, të datës 01.12.2023, e ka refuzuar kërkesën e paditësit-propozuesit M... B..., me adrese Rr "H... S..." nr.102, fshati B.../ G...- Gl.../ D..., me të cilën ka kërkuar që të shtyhet ekzekutimi i aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor për Certifikatën nr., si e pa bazuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi - propozuesi M... B..., për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovet shtyrja e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, të

ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.1972/23 i datës 01.12.02023.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së propozuesit-paditësit, kolegji i kësaj gjykate, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me të cilin Tërhiqet Certifikata Nr.257 e z. M... B..., për dhënien e provimit profesional nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, ka gjetur se paditësi nuk ka argumentuar se *ekzekutimi do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar*, ngase kërkesa për shtyrje të ekzekutimit duhet argumentuar mbi baza reale të *shkaktimit të dëmit të pariparueshëm*, vlera e të cilës është e pa kompensueshme në kuptimin material dhe monetar. Gjykata e shkallës së parë konstaton se pretendimet e paditësit nuk argumentojnë shkaktimin e dëmit të pariparueshëm, për faktin se dëmi eventual i cili do të mund të shkaktonte me ekzekutimin e vendimit dhe nëse në fund të procesit gjyqësor do të rezultonte se vendimi i atakuar është i kundërligjshëm atëherë dëmi i pretenduar do të mund të përcaktohej për kompensim me vendimin përfundimtar gjyqësor varësisht nga kërkesat në procedurë gjyqësore. Prandaj, gjykata gjatë vlerësimit të kërkesës së paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, iu ka referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: *“Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”*. Në rastin konkret propozuesi-paditësi me ankesën e ushtruar kërkon shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, me arsyetim se propozuesi i masës pretendon se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të LPK-së dhe gabimisht është vërtetuar gjendja faktike dhe është zbatuar e drejta materiale që ka ndikuar në mos nxjerrjen e vendimit meritor. Propozuesi i masës me faktet dhe provat e paraqitura në gjykatë konsideron se janë përmbushur në mënyrë komulative kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, e me të vetmin qëllim të shtyrjes së aktit administrativ, vendosjen përfundimtare të procesit gjyqësor, me refuzimin e propozimit nga ana e gjykatës propozuesit ju ka

rrezikuar ekzistenca, pasi që propozuesi i masës së sigurisë sipas certifikatës së fituar nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë ka gjeneruar të hyra mujore duke mbajtur familjen, andaj me mos aprovimin e kërkesës nga ana e gjykatës rrezikohet që ta humbi këtë të drejtë dhe të mbetem pa punë dhe pa të hyra mujore. Gjykata e shkallës së parë nuk mori për bazë dispozitën e nenit 22 par.2 të LKA-së për shtyrje të ekzekutimit deri në fund të procesit gjyqësorë, i cili aktvendim nuk do të ishte në kundërshtim me organin publik, por propozuesit të masës i sjell dëm të pa riparueshëm përkundër pritjes së epilogut përfundimtar gjyqësorë, e në rastin konkret propozuesi i masës i humb të ardhurat mujore të fituar si certifikues i sigurisë dhe shëndetit në punë dhe praktikisht mbetet me asistencë sociale.

Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të propozuesit - paditësit në ankesë të cekura më lartë, ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe të pa argumentuara me prova konkrete për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i këtij kolegji është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore në mënyrë kumulative për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji i kësaj gjykate gjen se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast paditësi - propozuesi në ankesën e ushtruar nuk ka dhënë ndonjë arsyetim të besueshëm me prova konkrete se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit të lartcekur, duke i'u referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendim.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.1010/2023, me datë 05.01.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi